



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.27, datë 03.10.2018

PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KKT-SË NR. 17, DATË 07.06.2016 "PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE ZHVILLIMI DHE NDËRTIMI BRENDA
ZONAVE TË RËNDËSISË KOMBËTARE"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit, së Zhvillimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Përmbajtja e shkronjës "a", të pikës 1, në Vendimin e KKT-së Nr. 17, datë 07.06.2016 "Për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimi dhe ndërtimi brenda zonave të rëndësisë kombëtare", ndryshon si më poshtë:
 - a. Për territoret ku ka plane të përgjithshme vendore në fuqi, përfshirë edhe ato të përmendura në Nenin 45, shkronja "a", të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, shqyrtimi dhe miratimi të kryhet në përputhje me këto plane dhe vetëm pas marrjes së përputhshmërisë nga Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTORI AGENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



LEDIA TOTA